

## **Treguesit për caktimin e normës në % të shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC)**

Në përputhje me rregulloren “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit” miratuar me vendimin nr.41, datë 05.06.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe udhëzimet e Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik, për përcaktimin e normës së shtesës kundërciklike të kapitalit përdoren treguesit e referencës. Këta tregues synojnë të reflekojnë në mënyrë sa më të drejtë ciklin e kreditimit dhe rreziqet që shoqërojnë rritjen e tepërt të kreditimit në vend, si edhe të konsiderojnë në mënyrë të përshtatshme specifikat e ekonomisë së vendit. Vlerat sasiore të treguesve janë gjithmonë subjekt i interpretimit dhe analizës së ekspertëve të cilët në analizë mund të përfshijnë edhe faktorë të tjerë cilësorë.

Midis treguesve të referencës, si *tregues parësor* shërben “hendeku i raportit të kredisë për ekonominë ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB)”, që paraqet devijimin e vlerës aktuale të raportit “kredi për ekonominë / PBB” nga prirja e tij afatgjatë. Ky tregues sinjalizon mundësinë e rritjes së tepërt të kreditimit në raport me rritjen ekonomike dhe eventualisht, rritjen e rreziqeve sistemike ciklike. Si *plotësues* të treguesit parësor, shërbejnë disa të tjerë të grupuar në treguesin e paralajmërimit të hershëm (TPHP). Krahas treguesit parësor, ky tregues përbëhet edhe nga pesë nëntregues të tjerë, të cilët sinjalizojnë zhvillimet në kreditim dhe në aktivet jofinanciare (tregu i pasurive të paluajtshme).

### **Arsyetimi mbi caktimin e normës në % të KUNC**

Tabelat në vijim paraqesin vlerat më të fundit të disponueshme të treguesve të përzgjedhur dhe mesataret historike përkatëse.


Nga tabela 1, vërehet që shifra e treguesit parësor regjistron vlera negative dhe larg vlerave të pragut krahasues që, si rregull, do të shoqërohej me rritjen e shtesës kundërciklike të kapitalit<sup>i</sup>. Vlera e treguesit është thelluar kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë dhe shfaq një përmirësim ndaj tremujorit paraardhës<sup>ii</sup>.

*Tabelë 1: Treguesi parësor*

Treguesi parësor <sup>iii</sup>	Mesatarja historike		T4-2021
	T4-2002 – T4-2008	T1-2009 – T3-2021	
Hendeku i kredisë për ekonominë ndaj PBB-së <sup>iv</sup>	1.9 pp	-7.9 pp	-7.0 pp <sup>v</sup>

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.

Grafik: Ecuria e hendekut të raportit “Kredi për ekonominë / PBB” në pikë përqindje



Burimi: Banka e Shqipërisë

Tabela 2 e treguesve plotësues, vijon të tregojë një zgjerim të ritmit rritës të kredisë për pasuri të paluajtshme përgjatë dymbëdhjetë muajve të fundit. Ndërkohe, indeksi i çmimit të banesave regjistron sërisht rritje kundrejt një viti më parë dhe periudhës paraardhëse. Është e rendësishme që ecuria e këtyre dy treguesve, të cilët priren të përforcojnë ecurinë e njëri-tjetrit, të monitorohet në vijimësi. Qëllimi është që, duke përdorur edhe informacionet që lidhen me ngarkesën me borxh të familjeve, të identifikohen dhe parandalohen situatat në të cilat ecuria e çmimeve në tregun e pasurive të paluajtshme është e paqëndrueshme.

Tabelë 2: Treguesit plotësues

Treguesit plotësues <sup>vi</sup>	Mesatarja historike (T4-2002 – T3-2021)	T4-2021
Intensiteti i kredisë për ekonominë <sup>vii</sup>	3.0%	3.0%
Ndryshimi vjetor i kredisë bankare për pasuri të paluajtshme	21.1%	12.6%
Ndryshimi vjetor i indeksit të “çmim i banesave / vlera e qirasë” <sup>viii</sup>	8.0%	10.4%
Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimit të banesave <sup>ix</sup>	5.4%	12.0%
Rritja vjetore e kredisë bankare <sup>x</sup>	14.6%	10.2%

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.

**Mars 2022**

Mbështetur në të dhënrat dhe analizën e treguesve të mësipërm, vlerësohet se rreziqet që lidhen me kreditimin e tepërt mbeten të kontrollueshëm, pavarësisht rritjes më të shpejtë të kreditimit.

Si rezultat norma e shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) për Shqipërinë, propozohet të vijojë të jetë 0%.

**SQARIME:**

<sup>i</sup> Rritja e shtesës kundërciklike të kapitalit mund të jetë e nevojshme edhe nëse vlerat e treguesit parësor janë më të vogla se pragu krahases. Ky është rasti kur, pavarësisht ecurisë së kredisë në përgjithësi, vërehen zhvillime të shpejta të kreditimit në sektorë të caktuar, të cilat konsiderohen të paqëndrueshme dhe burim reziku për qëndrueshmërinë e sistemit finansiar dhe të tregjeve.

<sup>ii</sup> Vlera e treguesit parësor ishte: [-6.24] pp në T4-2020, [-6.65] pp në T1-2021, [-7.81] pp në T2-2021 dhe [-7.85] pp në T3-2021.

<sup>iii</sup> Në analizën e vlerave në tabelë, duhet konsideruar që vlerat e llogaritura të treguesit parësor dhe të mesatares së tij historike, ndryshojnë për shkak të dy grupeve të faktorëve: a) zhvillimeve në vlerat e kredisë për ekonominë dhe të PBB-së; dhe b) rishikimeve të vlerave të PBB-së që kryen rregullisht Instituti i Statistikave (INSTAT). Këto dy grupe faktorësh mund të ndikojnë mbi vlerën e treguesit parësor, në të njëjtin kah ose në kahe të ndryshme.

<sup>iv</sup> Vlera e PBB-së është llogaritur si shuma e vlerave të katër tremujorëve të fundit. Për T4-2021, norma e rritjes reale të PBB-së është 5.52%. Vlera e rritjes ekonomike të periudhës mund të jetë subjekt rishikimi në periudhën pasardhëse nga INSTAT.

<sup>v</sup> Vlera e treguesit parësor për T4-2021 prej [-7.04] pp shënon një zgjerim (përkeqësim) të hendekut të kredisë në krahasim me vlerën e T4-2020 [-6.24]. Në këtë ndryshim ka ndikuar rritja më e lartë e produktit të brendshëm bruto kundrejt rritjes së kredisë për ekonominë.

<sup>vi</sup> Këta tregues, së bashku me treguesin parësor, përbëjnë “Treguesi i Paralajmërimit të Hershëm Plotësues”.

<sup>vii</sup> Vlera absolute e rritjes vjetore të kredisë për ekonominë si raport ndaj vlerës së vjetorizuar të PBB-së (shuma e vlerave të PBB-së për katër tremujorët e fundit).

<sup>viii</sup> Vlerat e indeksit zbuten për 8 tremujorët e fundit. Në T4-2020, metodologja e përllogaritjes të indeksit të qirasë ka ndryshuar duke sjellë edhe ndryshimin e vlerës mesatare historike të tij.

<sup>ix</sup> Vlerat e indeksit zbuten për 8 tremujorët e fundit. Në T2-2019, metodologja e ndërtimit të indeksit ka ndryshuar duke sjellë edhe ndryshimin e vlerës mesatare historike të tij.

<sup>x</sup> I referohet totalit të kredisë së dhënë nga sektori bankar për sektorin publik dhe atë privat jofinanciar.